



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.4.2023

Nr: 250

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KËSHILLIT BASHKIAK, BASHKIA ELBASAN, TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "BINDJA DEMOKRATIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 3.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën:

KËRKUES: Partia "Bindja Demokratike", me shkronja nistore "BD"

OBJEKTI: Miratimi i listës shumëmemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Elbasan, të subjektit zgjedhor "Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", dhe të shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Data: 3.4.2023 Nr: 250
Ora: 16:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumëmemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Elbasan, të subjektit zgjedhor "Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Me vendimin nr. 170, datë 11.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Partia “Bindja Demokratike” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti zgjedhor “Bindja Demokratike” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Elbasan, të subjektit zgjedhor “Bindja Demokratike” dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Elbasan, të subjektit zgjedhor “Bindja Demokratike”, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak rezulton se, të gjithë kandidatët e listave shumemërore nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me anë të komunikimit elektronik në datën 29.03.2023, ka dërguar verifikimin e të dhënave për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, dhe përkatësisht për Bashkinë:

Elbasan, të subjektit zgjedhor “Bindja Demokratike”, sipas së cilës rezulton se:

1. Kandidatët e propozuar në listën shumemërore nga subjekti zgjedhor “Bindja Demokratike” për këshillin bashkiak **Elbasan** (sipas lidhjes nr, 1), nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015. Rezultojnë të jenë të padënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkitë Durrës, Lezhë dhe Tiranë të subjektit zgjedhor “Partia Bindja Demokratike”.

Referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose shtrajnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të subjektit zgjedhor “Bindja Demokratike” nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Bindja Demokratike”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe në nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, në Bashkinë Elbasan, të subjektit zgjedhor “Bindja Demokratike”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Bindja Demokratike**Bashkia Elbasan****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Arian	Sami	Samarxhiu	13/03/1970	M
2	Rebiona	Bonin	Terolli	03/04/2002	F
3	Dejson	Behar	Kuqja	20/01/2002	M
4	Anila	Mustafa	Gashi	29/03/1971	F
5	Refat	Hamit	Lleshanaku	16/06/1964	M
6	Hatixhe	Bajram	Harja	05/09/1975	F
7	Gazmend	Halit	Bylyku	29/08/1966	M
8	Shqiponja	Xhaferr	Simitçiu	28/02/2000	F
9	Esmerald	Edmond	Zela	07/04/1995	M
10	Renata	Petrit	Terolli	25/03/1982	F
11	Kristo	Sajmir	Binjaku	02/08/2001	M
12	Argesta	Gerondi	Stërgu	14/11/1996	F
13	Blerim	Merkur	Sinani	29/05/1990	M
14	Manuela	Solli	Velo	24/09/1983	F
15	Bonin	Bashkim	Terolli	30/05/1977	M
16	Nevila	Ligor	Qosja	04/03/1992	F
17	Dashamir	Ferik	Qemali	09/04/1962	M
18	Zylfie	Amir	Shahinaj	08/03/1967	F
19	Ladimir	Bajram	Kodralliu	22/03/1987	M
20	Orjola	Vehbi	Samarxhiu	18/03/1982	F
21	Florenc	Agim	Toçi	08/04/1984	M
22	Shpresa	Reshit	Samurri	18/09/1975	F
23	Fialdo	Fatmir	Mema	20/04/2005	M
24	Majlinda	Qemal	Samurri	20/04/1976	F
25	Erlin	Xhevit	Kishta	14/09/1987	M
26	Romilda	Arjan	Kala	06/04/1994	F
27	Ronald	Xhaferr	Simitçiu	16/04/1998	M
28	Afërdita	Muhamet	Gjini	13/05/1979	F
29	Xhaferr	Nazmi	Simitçiu	21/04/1961	M
30	Frida	Fatmir	Zela	16/01/1977	F
31	Redi	Ndriçim	Hoxhaj	07/01/2005	M
32	Sara	Ilir	Koçi	20/12/1999	F
33	Ndriçim	Demir	Samurri	10/12/1971	M
34	Merita	Xhaferr	Simitçiu	09/11/1970	F
35	Elvin	Kamber	Muçelli	31/08/1969	M
36	Jorida	Ryzhdi	Samarxhiu	16/11/1988	F



Bindja Demokratike**Bashkia Elbasan****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
37	Agron	Ibrahim	Samurri	22/11/1976	M
38	Xheni	Xhaferr	Simitçiu	01/10/1995	F
39	Arjol	Agron	Samurri	20/03/1999	M
40	Mimoza	Zadef	Muçelli	29/04/1965	F
41	Xhevahir	Demir	Samurri	16/02/1976	M
42	Gentiana	Muhamet	Kala	22/06/1981	F
43	Fadil	Hamid	Sinani	29/06/1980	M
44	Servete	Hamdi	Kala	03/04/1956	F
45	Fatjon	Muhamet	Kala	02/06/1991	M
46	Lumturije	Ibrahim	Sinanaj	14/02/1956	F
47	Fatmir	Tahir	Sinanaj	10/02/1954	M
48	Enxhi	Luan	Miftari	12/02/1997	F
49	Edmond	Osman	Zela	25/10/1967	M
50	Naferit	Qamil	Harja	10/10/1944	F
51	Erjon	Agim	Roçi	03/12/2004	M
52	Sidorela	Ahmet	Kola	20/07/1999	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

52